



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 3 tetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit dhe Selimit për Shtyrjen e Dëshmimeve të W00208-ës, W04753-shit dhe W04491-shit

**Ushtruesit të Detyrës së
Zëvendësprokurorit të Specializuar**
Vard Ferdinandse

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 21(4)(c) dhe (f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 121 dhe 127 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shtator 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi mocion për pranimin e provave, midis të tjerash, të dëshmitarëve W00208, W04753 dhe W04491 ("dëshmitarët") në bazë të rregullës 154 ("Mocioni sipas Rregullës 154").¹
2. Më 15 shtator 2023, ZPS-ja bëri të njohur qëllimin për të thirrur dëshmitarët si dëshmitarë të "mundshëm rezervë" për bllokun e dëshmive gjatë periudhës 9 deri më 19 tetor 2023.²
3. Më 21 shtator 2023, pas diskutimeve *inter partes* pa rezultat,³ Mbrojtja e Hashim Thaçit dhe Rexhep Selimit ("Mbrojtja") dorëzoi kërkesë për shtyrjen e dëshmive të dëshmitarëve ("Kërkesa").⁴
4. Më 22 shtator 2023, ZPS-ja dorëzoi informacionin që kërkohet në paragrafin 74 të Urdhrit të Trupit Gjykues mbi Zhvillimin e Gjykimit ("Urdhri")⁵ në lidhje me dëshmitarët.⁶

¹ F01788, Prokurori i Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W00208, W02082, W02475, W04147, W04325, W04491, dhe W04753 sipas Rregullës 154*, 14 shtator 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-7, konfidenciale.

² Korrespondenca 320. *Shih gjithashtu F01807/A01, Mbrojtësi i Specializuar, Shtojca 1 e Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit dhe Selimit për Shtyrjen e Dëshmive të W00208-ës, W04753-shit dhe W04491-shit* (Shtojca 1 e Kërkesës), 21 shtator 2023, konfidenciale.

³ F01807/A02, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 2 e Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit dhe Selimit për Shtyrjen e Dëshmive të W00208-ës, W04753-shit dhe W04491-shit*, 21 shtator 2023, konfidenciale.

⁴ F01807, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit dhe Selimit për Shtyrjen e Dëshmive të W00208-ës, W04753-shit dhe W04491-shit*, 21 shtator 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1 dhe 2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 2 tetor 2023, F01807/RED.

⁵ *Shih F01226/A01, Trupi Gjykues, Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, para. 74(iv) dhe (vi).

⁶ F01811/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit nga Prokuroria të Listës së Dëshmitarëve Rezervë* ("Lista e Dëshmitarëve Rezervë"), 22 shtator 2023, konfidenciale.

5. Më 27 shtator 2023, ZPS-ja u përgjigj ndaj Kërkesës (“Përgjigjja”).⁷

6. Mbrojtja nuk u kundërpërgjigj.

II. PARASHTRIMET

7. Mbrojtja kërkon nga Trupi Gjykses që: (i) të shkurtojë afatin e përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores për dhënien e përgjigjes nga ZPS-ja ndaj Kërkesës; dhe (ii) të urdhërojë ZPS-në që të shtyjë dëshmitë e dëshmitarëve deri, më së hershmi, në bllokun e dëshmimeve të nëntorit 2023.⁸ Mbrojtja argumenton se njoftimi i vonshëm i ZPS-së për dëshmitë e afërta të dëshmitarëve ka efekt dëmtues sepse shkel të drejtat e të akuzuarve për kohë të mjaftueshme për t’u përgatitur për marrjen e tyre në pyetje.⁹ Mbrojtja thekson se ZPS-ja nuk dha njoftim paraprak për qëllimin për të thirrur dëshmitarët këtë vit, pasi ata nuk janë përfshirë në listën e ZPS-së të dyzet dëshmitarëve të parë, ose në listat e mëpasshme të dëshmitarëve.¹⁰ Mbrojtja pretendon se katër faktorët në vijim e përkeqësojnë dëmin: (i) ZPS-ja nuk ka dorëzuar informacionin e kërkuar në Urdhër në lidhje me dëshmitarët;¹¹ (ii) koha e kufizuar që do të ketë Trupi Gjykses për shqyrtimin e themelësisë së Mocionit sipas Rregullës 154 dhe koha e kufizuar pas kësaj që do të ketë për shqyrtimin e provave që do të konstatohet se janë të përshtatshme për t’u pranuar;¹² (iii) ZPS-ja nuk ka arsyetuar se pse disponueshmëria e W01504-ës dhe mënyra e dëshmisë janë ende duke u shqyrtuar;¹³ dhe (iv) dëshmitë e dëshmitarëve nuk kanë pjesë të njëjta.¹⁴ Mbrojtja përfundon se nuk mjaftojnë dy

⁷ F01820, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit dhe Selimit për Shtyrjen e Dëshmimeve të Dëshmitarëve Rezervë*, 27 shtator 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F01820/RED.

⁸ Kërkesa, para. 3, 15.

⁹ Kërkesa, para. 2, 8.

¹⁰ Kërkesa, para. 6-7.

¹¹ Kërkesa, para. 8 *i referohet* Urdhrit, para. 74(iv) dhe (vi).

¹² Kërkesa, para. 9.

¹³ Kërkesa, para. 10.

¹⁴ Kërkesa, para. 11.

deri në tri javë për t'u përgatitur për dëshmitarët dhe se shtyrja e dëshmive të tyre për një bllok më të vonshëm të dëshmive është e vetmja masë që siguron për Mbrojtjen njoftim dhe kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për marrje në pyetje.¹⁵

8. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të refuzohet si e parakohshme dhe e pabazë.¹⁶ ZPS-ja argumenton se Mbrojtja ishte njoftuar në kohë të mjaftueshme paraprakisht dhe kishte kohë dhe mjete për t'u përgatitur për marrje në pyetje.¹⁷ Ajo parashtron se asnjë dëm konkret nuk shkaktohet nga dëshmitë e mundshme të dëshmitarëve gjatë bllokut të dëshmive në periudhën 9-19 tetor 2023 ("blloku i tetorit").¹⁸ ZPS-ja argumenton se njoftimi për dëshmitë e dëshmitarëve në këtë fazë kërkohej për shkak të numrit të dëshmitarëve rezervë të thirrur në blloqet e dëshmive nga korriku deri në shtator 2023.¹⁹ ZPS-ja pretendon se vlerësimet e pasakta të kohëzgjatjes për marrje në pyetje ishin shkak për numrin e madh të dëshmitarëve rezervë të thirrur për të dëshmuar deri më sot.²⁰ ZPS-ja gjithashtu parashtron se, nga dëshmitarët që u njoftuan më parë për dëshmi, dy nuk janë thirrur ende, por asnjëri prej tyre nuk është i përshtatshëm për bllokun e tetorit.²¹ Ajo shpjegon se identifikimi dhe njoftimi i dëshmitarëve rezervë është rezultat i shqyrtimit të kujdesshëm të shumë faktorëve që shpesh janë konkurrues me njeri-tjetrin.²² ZPS-ja parashtron se: (i) njoftoi Mbrojtjen për dëshmitarët më 14 shtator 2023; (ii) dorëzoi informacionin e kërkuar në paragrafin 74 të Urdhrit më 22 shtator 2023; dhe (iii) është vetëm një dokument qa ajo synon të përdorë me dëshmitarët e që nuk është dorëzuar më parë si provë materiale shoqëruese në Mocionin sipas

¹⁵ Kërkesa, para. 12.

¹⁶ Përgjigja, para. 1, 10.

¹⁷ Përgjigja, para. 1.

¹⁸ Përgjigja, para. 1.

¹⁹ Përgjigja, para. 2.

²⁰ Përgjigja, para. 3.

²¹ Përgjigja, para. 2.

²² Përgjigja, para. 4.

Rregullës 154.²³ Ndërsa pranon se dëshmitë e dëshmitarëve nuk kanë pjesë të njëjta, ZPS-ja argumenton se: (i) dëshmitë e W04491-shit dhe W04753-shit kanë të bëjnë me shumë pika të njëjta; dhe (ii) kuadri i dëshmisë së W00208-ës dhe materiali përkatës janë të kufizuar.²⁴ ZPS-ja parashtron se nevoja për t'i thirrur dëshmitarët mbetet hipotetike dhe midis të tjerash, varet nga, vlerësimet e sakta të kohëzgjatjes së marrjeve në pyetje nga Mbrojtja.²⁵ ZPS-ja gjithashtu shton se është në dispozicion për të komunikuar *inter partes* për çdo pikë, sidomos duke pasur parasysh dëmin që është i vërtetueshëm, dhe se vetëm pas këtyre konsultimeve *inter partes*, Mbrojtja duhet të kërkojë mjet juridik nga Trupi Gjykses.²⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Sipas Urdhrit:

74. ZPS-ja i rendit dëshmitarët në **renditje paraprake** sipas të cilës do të thirren, duke i identifikuar nëse është nevoja sipas grupimit. **Pas kësaj, ZPS-ja njofton Trupin Gjykses dhe palët dhe pjesëmarrësit në kohën e duhur për çdo ndryshim në renditjen e propozuar të paraqitjes së dëshmitarëve.** Kjo përfshin:

- i. Emrin dhe pseudonimin e dëshmitarit, në varësi të masave mbrojtëse;
 - ii. Të gjitha deklaratat e mëparshme ose transkriptet e dëshmise të dëshmitarit;
 - iii. Nëse ZPS-ja propozon që dëshmitari duhet të dëshmojë pjesërisht ose tërësisht duke qenë i pranishëm, dhe nëse ZPS-ja synon të paraqesë deklaratën ose transkriptin e dëshmisë së dëshmitarit në pajtim me rregullën 154;
 - iv. Pikat, faktet dhe rrethanat në lidhje me të cilat do të merret në pyetje dëshmitari;
 - v. Kohëzgjatja e nevojshme që vlerësohet për pyetje nga pala thirrëse;
 - vi. Dokumentet dhe provat materiale që ZPS-ja propozon t'i përdorë me këtë dëshmitar, dhe numrin e provës materiale apo numrin identifikues MFI të të gjitha atyre që janë pranuar si prova apo që janë shënuar për identifikim;
- [...]

77. Në fund të çdo blloku prej tri javësh të seancave, pala që thërret dëshmitarët njofton Trupin Gjykses dhe palët dhe pjesëmarrësit e tjerë për dëshmitarët që synon të thërrasë gjatë bllokut të ardhshëm prej tri javësh të seancave.

²³ Përgjigjja, para. 5-6.

²⁴ Përgjigjja, para. 7.

²⁵ Përgjigjja, para. 8.

²⁶ Përgjigjja, para. 8.

78. Të enjten, në orën 16:00, në çdo javë që vjen para javës në të cilën do të dëgjohen dëshmitarët, pala që thërret dëshmitarët njofton Trupin Gjykses dhe palët dhe pjesëmarrësit e tjerë për dëshmitarët që synon të thërrasë gjatë javës së ardhshme.

80. **Është detyrë e palës paraqitëse që të njoftojë** Trupin Gjykses, palët dhe pjesëmarrësit e tjerë, dhe Zyrën Administrative **sa më parë që të jetë e mundshme për ndryshimet në renditjen e dëshmitarëve** dhe ose për çdo ndryshim të listës së provave materiale (të propozuara) që synon të përdorë me dëshmitarët.

81. Është përgjegjësi e palës paraqitëse të sigurojë që, kur një dëshmitar përfundon dëshminë, dëshmitari tjetër të jetë gati të fillojë të dëshmojë. Nëse një nga dëshmitarët e propozuar nuk është në gjendje të dëshmojë në kohën e përcaktuar apo nëse nuk merret në pyetje dëshmitari ose nëse marrja në pyetje kryhet më shpejt se që pritej, **pala paraqitëse siguron që mund të thirret një dëshmitar alternativ për t'i shmangur vonesat në proces.** Vetëm ata dëshmitarë për të cilët është dhënë njoftim sipas paragrafit 77 mund të thirren si dëshmitarë alternativë, përveç nëse trupi gjykses jep leje paraprakisht.

84. **Palët dhe pjesëmarrësit udhëzohen që të arrijnë pajtim, kur është e mundshme, në lidhje me rendin e thirrjes së dëshmitarëve në javën që vjen.** Trupi Gjykses rezervon të drejtën të urdhërojë palët dhe pjesëmarrësit që të ndryshojnë rendin e propozuar të thirrjes së dëshmitarëve.²⁷

IV. DISKUTIM

10. Që në fillim, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja u përgjigj ndaj Kërkesës më 27 shtator 2023, *d.m.th.* pesë ditë para afatit të përcaktuar në rregullën 76. Rrjedhimisht, pjesa e Kërkesës ku kërkohet shkurtimi i afatit për ZPS-në për t'u përgjigjur ndaj Kërkesës është e tejkualuar.

11. Trupi Gjykses i kthehet pjesës së mbetur të Kërkesës, *d.m.th.* shtyrjes së kërkuar të dëshmimeve të dëshmitarëve deri, më së hershmi, në bllokun e ardhshëm të dëshmimeve. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses pranon se dëshmitarët nuk ishin përfshirë në listën e ZPS-së të 40 dëshmitarëve të parë, as në listat e dëshmitarëve të dorëzuara më vonë.²⁸ Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se më 15 shtator 2021 Mbrojtja u njoftua për

²⁷ Urdhri, para. 74, 77-78, 80-81, 84.

²⁸ *Shih* F01117, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës Paraprake të 40 Dëshmitarëve të Parë që do të Thirren në Gjykim*, 18 nëntor 2022, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F01243, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës së 12-të Dëshmitarëve të Parë dhe Informacionit Shoqërues*, 1 shkurt 2023, me Shtojcën 1, konfidenciale; F01630, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim nga Prokuroria i Listës së 12 Dëshmitarëve të Tjerë, Dëshmitarëve Rezervë dhe Informacionit Shoqërues*, 28 qershor 2023, me Shtojcat 1 dhe 2, konfidenciale, dhe Shtojcën 3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

mundësinë që dëshmitarët të dëshmojnë gjatë bllokut të tetorit,²⁹ *d.m.th.* së paku tri javë para fillimit të bllokut të tetorit të dëshmitarëve. Trupi Gjykses vë në dukje më tej se ky njoftim u dha disa javë shtesë para se ndonjëri nga këta dëshmitarë do të thirren, sepse ata mund të thirren vetëm si “rezervë” për dëshmitarët në listë në qoftë se këta nuk mund të dëshmojnë dhe/ose kur ka kohë të lirë në kalendar, që e bën të domosdoshme thirrjen e tyre. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon si të pasaktë parashtrimin e Mbrojtjes se ZPS-ja njoftoi për synimin që të mbështetet në dëshmitarët “afërsisht tri javë para dëshmime të tyre të mundshme”³⁰. Katër dëshmitarët të caktuar për bllokun e tetorit janë W03880, W04577, W04769 dhe W04448. Kjo do të thotë se më së hershmi dëshmitari i parë i dëshmitarëve që *mund* të thirret të dëshmojë, në çdo rast, do të ishte gjatë pjesës së fundit të bllokut të tetorit. Duke pasur parasysh se ZPS-ja njoftoi për dëshmitë e mundshme të dëshmitarëve më 15 shtator 2023,³¹ Mbrojtja do të ketë së paku një muaj kohë për t’u përgatitur për dëshmitarët.

12. Gjithashtu, dëshmitarët janë “dëshmitarë të mundshëm rezervë”. Është e qartë nga natyra e dëshmitarëve *rezervë* që nevoja për t’i thirrur dëshmitarët të dëshmojnë në bllokun e tetorit varet kryesisht se si ecën marrja në pyetje e dëshmitarëve *jorezervë*.³² Dëshmitarët do të dëshmojnë në bllokun e tetorit *vetëm nëse* dëshmitë e dëshmitarëve (*jorezervë*) të caktuar përfundon më shpejt se që pritet ose nuk janë më në gjendje të dëshmojnë për arsye të paparashikuara. Në këtë kuptim, Kërkesa e Mbrojtjes gjithashtu është e parakohshme. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses gjithashtu kujton se sa më i saktë të jetë vlerësimi i kohëzgjatjes që jepet nga palët, aq më pak ka të ngjarë që dëshmitarët (“e mundshëm rezervë”) të duhet të thirren të dëshmojnë.³³

13. Duke u bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se Mbrojtja do të ketë kohë të mjaftueshme të përgatitet për marrjen në pyetje të dëshmitarëve (të

²⁹ Korrespondenca 320. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Kërkesës.

³⁰ Kërkesa, para. 6.

³¹ Korrespondenca 320. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Kërkesës.

³² Transkripti i seancës, 10 korrik 2023, f. 5259-5261 (“Urdhri Gojor mbi Paraqitjen e Dëshmitarëve Rezervë”).

³³ Urdhri Gojor mbi Paraqitjen e Dëshmitarëve Rezervë.

mundshëm) nëse ndonjëri nga dëshmitarët e propozuar duhet të thirret gjatë bllokut të tetorit. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje në këtë aspekt se ZPS-ja e ka dhënë radhën e thirrjes së dëshmitarëve rezervë, duke i mundësuar Mbrojtjes të përgatitet sipas radhës së thirrjes së mundshme të dëshmitarëve.³⁴

14. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se ZPS-ja nuk dha informacionin e kërkuar në paragrafin 74(iv) dhe (vi) të Urdhrit,³⁵ Trupi Gjykses vëren se, më 22 shtator 2023, ZPS-ja dha informacion në lidhje me: (i) pikat, faktet dhe rrethanat në lidhje me të cilat do të merreshin në pyetje dëshmitarë; dhe (ii) dokumentet dhe provat materiale të propozuara për t'u përdorur me dëshmitarët.³⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja dha informacionin e kërkuar dhe hedh poshtë argumentet e Mbrojtjes për të kundërtën.

15. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se do të ketë pak kohë para dëshmisë së dëshmitarëve për të shqyrtuar provat e pranueshme të dëshmitarëve duke pasur parasysh vendimin e pritshëm të Trupit Gjykses në lidhje me Mocionin sipas Rregullës 154,³⁷ Trupi Gjykses vë në dukje si në vijim. Trupi Gjykses pranon se me të vërtetë do të ketë pak kohë nga lëshimi i vendimit të vet në lidhje me Mocionin sipas Rregullës 154 dhe dëshmisë së mundshme të dëshmitarit të parë. Megjithatë, Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja është njoftuar për provat e propozuara të këtyre dëshmitarëve sepse deklaratat e tyre u nxorën për Mbrojtjen. Gjithashtu, në Mocionin sipas Rregullës 154 që u dorëzua më 14 shtator 2023, ZPS-ja e ka bërë të qartë se në cilat deklaratat të atyre dëshmitarëve do të donte të mbështetej. Siç është shpjeguar më lart, duke pasur parasysh se dëshmitari i parë që *mund* të dëshmojë, nuk do ta bëjë këtë para pjesës së vonshme të bllokut të tetorit, Trupi Gjykses gjykon se Mbrojtja do të ketë kohë të mjaftueshme që të përgatitet në mënyrë të duhur për marrje në pyetje. Trupi Gjykses përsërit se ZPS-

³⁴ *Shih* Listën e Dëshmitarëve Rezervë.

³⁵ Kërkesa, para. 8.

³⁶ *Shih* Listën e Dëshmitarëve Rezervë.

³⁷ Kërkesa, para. 9.

ja e dha renditjen sipas të cilës do të thirren dëshmitarët, nëse është e nevojshme.³⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se Mbrojtja është në gjendje të bëjë përgatitjen e dëshmitarëve duke u bazuar në radhën e njoftuar nga ZPS-ja.

16. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se ZPS-ja nuk arsyetoi se pse ende po shqyrtohet disponueshmëria e W01504-ës dhe mënyra e dëshmisë së tij, Trupi Gjykses vëren se: (i) ZPS-ja njoftoi Mbrojtjen dhe Trupin Gjykses për këtë informacion në korrik 2023;³⁹ dhe (ii) ZPS-ja tregoi se do të japë “informacion të mëtejshëm në lidhje me këtë dëshmitar sa më shpejt që të jetë e realizueshme”.⁴⁰ Gjithashtu, Trupi Gjykses kujton se duhet të ketë njëfarë shkalle fleksibiliteti në lidhje me radhën e paraqitjes së dëshmitarëve rezervë për shkak të natyrës së këtyre dëshmitarëve.⁴¹ Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se, në këtë fazë, mënyra e dëshmisë, për të cilën është njoftuar Mbrojtja është rregulla 154 dhe ajo duhet të përgatitet në këtë moment duke u bazuar në të deri në njoftimin e ardhshëm, nëse do të ketë. Trupi Gjykses gjykon se mungesa e arsyetimit konkret se pse një dëshmitar rezervë i njoftuar më parë nuk është caktuar para dëshmitarëve nuk është, në vetvete, bazë e mjaftueshme për shtyrjen e dëshmisë së dëshmitarëve rezervë alternativë.

17. Së fundi, sa i përket argumentit të Mbrojtjes se mungesa e pjesëve të njëjta në dëshmitë e dëshmitarëve e ndërlikon më tej përgatitjen e saj për marrje në pyetje,⁴² Trupi Gjykses vëren se: (i) dëshmitë e dy prej dëshmitarëve (W04491 dhe W04753) kanë të bëjnë me vendndodhjet e krimeve të përfshira në aktakuzë të përmendura nga dëshmitarë të tjerë që janë caktuar të dëshmojnë ose kanë përfunduar dëshminë; dhe (ii) kuadri i dëshmisë së W00208-ës, dhe materiali përkatës, janë

³⁸ *Shih, përsëri, Listën e Dëshmitarëve Rezervë.*

³⁹ *Shih F01673, Prokurori i Specializuar, Kërkesë e Prokurorisë në lidhje me Materialet në lidhje me W03832-shin dhe Kërkesën sipas Rregullës 154 për W01504-ën, 14 korrik 2023, konfidenciale, para. 3. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 17 korrik 2023, F01673/RED.*

⁴⁰ *Shih Përgjigjen, poshtëshënimi 8.*

⁴¹ *Urdhri Gojor mbi Paraqitjen e Dëshmitarëve Rezervë.*

⁴² *Shih Kërkesën, para. 8.*

mjaftë të kufizuar. Edhe pse është e dëshirueshme thirrja njëri pas tjetrit e dëshmitarëve që kanë lidhje me njëri tjetrin, kjo nuk është çdo herë e mundshme dhe Trupi Gjykses nuk do ta përdorë kompetencën diskrecionale për ta parandaluar ZPS-në që të thërrasë dëshmitarë që kanë lidhje me njëri tjetrin në momente të ndryshme gjatë paraqitjes së argumenteve të veta. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk bindet nga argumentet e Mbrojtjes se paraqitja e dëshmimeve që nuk kanë ngjashmëri me njëra-tjetrën pengon përgatitjet për marrje në pyetje.

18. Duke pasur parasysh sa më lart, meqenëse dëshmitarët janë aktualisht vetëm dëshmitarë të “mundshëm rezervë”,⁴³ Trupi Gjykses është i mendimit se kërkesa për shtyrje është e parakohshme dhe përndryshe e pathemeltë. Në veçanti, Trupi Gjykses është i bindur se Mbrojtja mori njoftim të mjaftueshëm dhe do të ketë kohë të mjaftueshme që të përgatitet në mënyrë të përshtatshme për dëshmitë (e mundshme) të dëshmitarëve. Për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk është i bindur se shtyrja (e mundshme) e dëshmimeve të dëshmitarëve deri në bllokun e ardhshëm të dëshmimeve është e përligjur në këto rrethana.

V. VENDIM

19. Trupi Gjykses:

- a) **DEKLARON** se kërkesa për shkurtimin e afatit për ZPS-në për t'u përgjigjur është e tejkaluar; dhe
- b) **HEDH POSHTË** kërkesën për shtyrjen e dëshmimeve të dëshmitarëve.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

⁴³ Korrespondenca 320. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Kërkesës.

E martë, 3 tetor 2023

Në Hagë, Holandë.